

L I G J
Nr.9582, datë 13.7.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8637, DATË 6.7.2000 “PËR POLICINË ELEKTRIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8637, datë 6.7.2000 “Për Policinë Elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 14 paragrafi i tretë dhe i katërt ndryshohen si më poshtë:

“Të ardhurat nga gjobat, nga vjelja e debive dhe shlyerjet e dëmeve, të realizuara prej Policisë Elektrike, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Përgjashtimisht, për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime dhe shpenzime operative në Policinë Elektrike, është sipas buxhetit të vitit 2006 të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Struktura dhe organika e Policisë Elektrike përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, brenda numrit të punonjësve të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për ministrinë e linjës. Pagat dhe shpërblimet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4998, datë 25.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu